V E N D I M
Nr.504, datë 8.11.1999

PËR KRIJIMIN E KOMITETIT TË ADMINISTRIMIT TË HUAVE TË BRENDSHME

Në mbështetje në nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 39, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Financave,

KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I:

1. Të krijojë Komitetin e Administrimit të Huave të Brendshme, me përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe të Bankës së Shqipërisë, i cili ka përgjegjësi:

- për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë dhe politikën e financimit për të ardhmen e afërt;
- për rishikimin e gjendjes së sotme ekonomike dhe të tregut të parasë dhe perspektivat afatshkurtra të tyre;
- për rishikimin e gjendjes së sotme dhe atë të parashikuar në cash, të Qeverisë dhe kërkesat e saj për huamarrje;
- për futjen e procedurave operacionale dhe institucionale, të nevojshme për emetimin e letrave me vlerë të Qeverisë;
- për ndryshimet në rregulloren dhe procedurat, që ndiqen në tregun e bonove të thesarit.

2. Komiteti i Administrimit të Huave të Brendshme përbëhet nga:

- Zëvendësministri i Financave;
- Zëvendësguvernatori i Bankës së Shqipërisë;
- Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave;
- Drejtori i Drejtorisë së Thesarit në Ministrinë e Financave;
- Drejtori i Drejtorisë së Borxhit në Ministrinë e Financave;
- Drejtori i Departamentit të Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë;
- Drejtori i Departamentit të Politikës Monetare në Bankën e Shqipërisë;
- Përgjegjësi i Sektorit të Borxhit të Brendshëm në Ministrinë e Financave;
- Specialisti për letrat me vlerë në Bankën e Shqipërisë.

3. Komiteti mblidhet jo më pak se 1 herë në tre muaj.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta